

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE



Tel. 038/338766555

+383-49766336

+383-49766361

www.higjiena.com

HIGJIENA SH.A.	
Nr. Prot:	890
B-Prot:	
Prot Nr:	
Nr. Recurve:	
Bl. etenje:	
No. pages:	
Date:	
Date:	
Date:	
DECAN	DECANI

PLANI I BIZNESIT

2024

Deçan, 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	3
1.1 Historiku i Ndërmarrjes	4
1.2 Korniza ligjore	4
1.3 Aktivitet primare, sekondare dhe të tjera	5
1.4 Klientët	6
2. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT E KOMPANISË	6
2.1 Vizioni	6
2.2 Misioni	7
2.3 Qëllimi i Kompanisë	7
2.4 Objektivat e Kompanisë	7
2.5 SWOT Analiza e Ndërmarrjes Publike Lokale “Higjiena” Sh.A. Deçan	9
3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E N.P.L “HIGJIENA” SH.A	12
4. SEKTORI I OPERATIVËS	13
4.1 Pajisjet / Makineritë	14
5. SEKTORI FINANCIAR	15
5.1 Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve	16
6. SEKTORI PËR INKASIM/FATURIM DHE MARRËDHËNIE ME Klientë	19
6.1 Zgjerimet në zonat rurale	20
6.2 Çmimorja e tarifave të konsumatorëve	20
7. SEKTORI ADMINISTRATIV JURIDIK	21
7.1 Njësia e Burimeve Njerëzore	21
7.2 Njësia Ligjore	22
7.3 Njësia e Arkivit	22
7.4 Njësia për Sigurinë e Objekteve dhe Mbrojtja e Punëtorëve	23
7.5 Mbrojtja në punë e punëtorëve	23
8. SEKTORI I PROKURIMIT	23
8.1 Planifikimi i Planit të Prokurimit	23
9. PLANI I MARKETINGUT	25
10. PROJEKTET, SFIDAT DHE REZULTATET E PRITSHME	27

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Plani i biznesit për vitin 2024, paraqet orientimet e Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjena" Sh.A, në realizimin e objektivave të parashtruara për vitin fiskal 2024, në mënyrë që kompania të ngrisë nivelet e saja në të gjitha aspektet. Ky plan biznesi hartohej me qëllim të përmirësimit të nivelit të kualitetit të shërbimeve, qëndrueshmërini dhe forcimin e pozicionit financiar, duke arritur pritshmëritë dhe kënaqësitë e komunitetit të Deçanit, siç janë: konsumatorët, bizneset dhe institucionet lokale në qytetin e Deçanit së bashku me fshatra.

Përmes këtij plani të biznesit, synohet të arrihet një dokument bazë, me anë të të cilit, në një periudhë një vjeçare, Kompania do mundohet të arrijë përbushjen e objektivave të parashtruara, aktivitetet e vitit 2024, rritjen e përqindjes së inkasimit në rajonet rurale ku është arritur zgjerimi i ofrimit të shërbimeve nga N.P.L "Higjena" Sh.A, rritjen e të hyrave përmes kontratave me bizneset dhe amvisëritë. Po ashtu, forcimi i bashkëpunimit me Kuvendin Komunal në Deçan, duke arritur marrëveshje të reja, për mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese, institucione publike e shumë shërbime tjera, investimet në përmirësimin e makinerive të Kompanisë dhe rritjen e shkallës së arkëtimit të borxheve, përmes procedurave përmbaruese e gjyqësore.

Detyra thelbësore e Ndërmarrjes është që të ofroj shërbime për grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe heqjen e mbeturinave në territorin e komunës së Deçanit. Ky dokument përshkruan në mënyrë të detajuar afarizmin vjetor të Ndërmarrjes, duke u bazuar mbi politikat në të cilat operon Ndërmarrja. Në këtë plan biznesi janë pasqyruar veprimtaritë dhe operacionet e planikuara të Kompanisë për vitin 2024, për secilin Sektor të Kompanisë. Në fund janë të paraqitura pasqyrat financiare për vitin 2024, dhe krahasimi i tyre me periudhën bazë (vitin 2023).

Ky dokument është produkt i një bashkëpunimi të rrjedhshëm dhe një interaksi intensiv e gjithëpërfshirës i akterëve të përfshirë në punën e N.P.L "Higjena" Sh.A, duke filluar me stafin menaxhues dhe operativ, anëtarët e Bordit të Drejtoreve, Komisionit Komunal të Aksionarëve, grupeve të konsumatorëve dhe institucioneve tjera, të cilat janë të ndërlidhura direkt me punën e N.P.L "Higjena" Sh.A.

1.1 Historiku i Ndërmarrjes

N.P.L “Higjiena” Sh.A, është Ndërmarrje e specializuar dhe e licencuar në kryerjen e shërbimeve me rëndësi të veçantë shoqërore për jetën e qytetarëve: bartjen e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjenës publike. Rajoni ku shërben Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” Sh.A përfshin territorin e komunës së Deçanit.

Ndërmarrja është në funksion që nga viti 2019. Nga viti 2019, Ndërmarrja “Higjiena”, ka filluar e vetme shërbimet për menaxhimin e mbeturinave, si një njësi operacionale në 100% të territorit të komunës së Deçanit.

Kompania funksionon si Shoqëri Aksionare, me emër N.P.L “Higjiena” Sh.A-Deçan, ku pronare e saj është Komuna e Deçanit (me 100% të aksioneve), e organizuar përmes trupave mbikëqyrëse dhe udhëheqëse të Kompanisë së janë: Komisioni Komunal i Aksionarëve, Bordi i Drejtoreve dhe Stafi Menaxhues.

Veprimitaria e Ndërmarrjes ushtrohet kryesisht me vetë financim, ku Ndërmarrja ka dy departamente kryesore: Administrata dhe Operativa, me seli në Rrugën Bjeshkët e Deçanit, p.n. Deçan, objekti i N.P.L “Higjiena” Sh.A. Kompania aktualisht ka një staf prej 64 punëtorësh, e cila operon në të gjitha fshatrat e Komunës së Deçanit.

1.2 Korniza ligjore

Si Ndërmarrje Publike funksionon sipas kornizës ligjore, Statutit të Ndërmarrjes, Ligjit për Ndërmarrjet Publike 03/L-087, i plotësuar 04/L-111, Ligji për Shoqëri Tregtare 06/L-016, Ligji për mbeturina 04/L-060, si dhe Ligji për Qeverisje Lokale 04/L 040.

N.P.L "Higjiena" Sh.A, veprimtarinë e saj e ushtron në baza ditore, duke ofruar shërbime në kohë reale, cilësore dhe duke u munduar që gjithmonë të përmirësojë dhe përbushë nevojat e klientëve, me synimin e përmirësimit të përhershëm të shërbimit të mbeturinave.

1.3 Aktivitet primare, sekondare dhe të tjera

Ndërmarrja kryen lloje të ndryshme të aktiviteteve, dhe sigurisht ajo bën renditjen e veprimitarës së saj në bazë të prioritetit të aktiviteteve. Më poshtë do i paraqesim në formë tabelare aktivitetet e Ndërmarrjes:

1.	Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme	Primarë
2.	Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme	Sekondarë
3.	Pastrimi i rrugëve	Tjera
4.	Mirëmbajtja e memorialeve dhe lapidarëve	Tjera
5.	Mirëmbajtja e gjelbërimit dhe parqeve	Tjera
6.	Mirëmbajtja e hapësirave tjera publike	Tjera
7.	Rregullimi (dekorimi) i qytetit për festa	Tjera
8.	Aktivitetet tjera të pastrimit	Tjera

Duke synuar zhvillimin e teknologjisë dhe makinerive, Kompania ka për qëllim rritjen e cilësisë së këtyre aktiviteteve e rrjedhimisht të arrijë kontrata fitimprurëse me kualitetin e shërbimeve që Ndërmarrja ofron.

1.4 Klientët

Ndërmarrja Publike Lokale "Higjiena" Sh.A, ka për obligim pjesën operacionale të menaxhimit të mbeturinave të lëngshme dhe të ngurta, përbrenda kufijve administrativ të Komunës së Deçanit. Kompania ofron shërbime për konsumatorët e ekonomive familjare, bizneset e vogla dhe të mëdha, si dhe institucionet lokale, (shkollat, spitalet, muzetë, stadiumet e palestrat sportive, ndërmarrjet publike etj).

Konsumatorët e amvisërive ndahen në 2 kategori kryesore, në ato që e pranojnë shërbimin derë më derë dhe ato të cilat janë të pajisur me kontejnerë kolektiv. Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme të cilat pranojnë shërbimin pa kontrata dhe bizneset të mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Bizneset e vogla dhe të mesme një pjesë e tyre shërbehet me shërbimin derë më derë dhe pjesa tjetër është e pajisur me kontejnerë të veçantë. Bizneset me kontrata janë të pajisura me kontejnerë të veçantë $1.1m^3$ apo 240 l. Institucionet janë kategoria e tretë, që zakonisht shërbehen me kontejnerë të veçantë. Po ashtu, konsumatorët i ndajmë në rezident dhe jo rezident dhe më poshtë në plan do i paraqesim në formë tabelare faturimet e tyre.

2. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT E KOMPANISË

2.1 Vizioni

Vizioni i Ndërmarrjes N.P.L "Higjena" Sh.A, është që qyteti i Deçanit së bashku me fshatra të jetë sa më i pastër. Rritja e nivelit të kualitetit të shërbimeve, zhvillimi i shërbimeve tjera siç janë, përpunimi i planit të riciklimit të mbeturinave, përmirësimi i makinerive, arritura e pozicionit stabil financiar në plan afatgjatë, rritja e përqindjes së faturimit dhe inkasimit dhe digitalizimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave.

2.2 Misioni

Misioni i Ndërmarrjes N.P.L “Higjiena” Sh.A., është ofrimi i shërbimit të mbledhjes së mbeturinave për të gjithë banorët e rajonit të Deçanit. Arritja e vet-qëndrueshmërisë financiare dhe orientim të shërbimeve sipas praktikave më të mira ndërkomëtare të kompanive publike. Sigurimi i shërbimeve në pajtim me standartet e përcaktuara sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për menaxhimin dhe administrimin e mbeturinave është mision i përhershëm i Kompanisë.

2.3 Qëllimi i Kompanisë

Qëllimi i Ndërmarrjes Publike Lokale ”Higjiena” Sh.A., është mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave, pastrimi i rrugëve dhe hapësirave të përbashkëta publike, mirëmbajtja dhe gjelbërimi i parqeve dhe hapësirave tjera të gjelbërta. Kontrata te reja me Biznese, Institucione për shërbimet që N.P.L ”Higjiena” Sh.A., ofron.

2.4 Objektivat e Kompanisë

Më poshtë do paraqesim objektivat e Kompanisë për vitin 2024:

- Forcimin e kapaciteteve të N.P.L ”Higjiena” Sh.A, që të rrisë kualitetin e shërbimeve, (pajisje mekanike, automjete, GPS, softuer etj).
- Modernizmin e sistemit të financave dhe kontabilitetit me anë të programeve të reja të cilat do ta rrisin cilësinë dhe kualitetin e shërbimeve të faturimit dhe inkasimit, Burimeve Njerëzore, Operative, marrëdhënieve me klientë, informimin në kohë reale të klientëve, kënaqshmëria me shërbimet e ofruara nga kompania etj.
- Përmirësimin e kapaciteteve të personelit nëpërmes ngritisë profesionale dhe avancimin e tyre në mënyrë që tu përgjigjen kërkesave të qytetarëve, dhe nevojave

të kompanisë me organizimin e ri.

- Zgjerimin e bazës së klientëve dhe ofrimin e kontratave të reja për ta, për të tri kategoritë: amvisëritë, bizneset dhe institucionet;
- Forcimin e bashkëpunimit me institucionet kommunale lokale, (Drejtorinë e Inspektionit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Zyra për Menaxhimin e Mbeturinave, Drejtorinë e Urbanizmit dhe drejtoritë tjera), në mbarëvajtjen dhe securinë e shërbimeve tonë;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me përmbarues për zgjidhjen e problemeve të borxheve. Respektimin e procedurave për arkëtimin e këtyre borxheve;
- Kooperimin dhe zhvillimin e projekt initiativave të cilat do të forcojnë kapacitetet e N.P.L “Higjiena” Sh.A., nëpërmes marrjes së donacioneve dhe përkrahjes financiare nga agjencitë dhe organizatat të cilat operojnë në Kosovë e më gjerë.
- Bashkëpunimi me ministritë përkatëse të Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e ndërmarrjes në projekte madhore.
- Inkurajimin e bashkëpunimit në mes të N.P.L “Higjiena” Sh.A., PAMKOS dhe kompanive simotra të cilat operojnë në Kosovë e më gjerë.
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative.
- Zhvillimi i planit për riciklinin dhe kompostimin e mbeturinave.

2.5 SWOT Analiza e Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena" Sh.A. Deçan

PËRPARËSITË	DOBËSITË
<p>PËRPARËSITË</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përvojë në ofrimin e shërbimeve për bartjen e mbeturinave, • Konsumatorët nga tri kategoritë të kënaqur me shërbimet, • Personeli / stafi ka përvojë në organizimin e punëve operative dhe mbulimin cilësor të terrenit, • Kapacitetet e nevojshme në mekanizëm dhe automjete për ofrimin e shërbimeve në regjionin e Deçanit, • Kompani e licencuar nga Ministria e Planifikimit dhe Zhvillimit Hapësinorë për bartjen e mbeturinave, • Kontrata dhe bashkëpunim të qëndrueshëm më Kuvendin Komunal të Deçanit, • Kooperim dhe koordinim me rrjetin PAMKOS dhe Institucionet tjera 	<p>DOBËSITË</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të hyra të pa arkëtuara nga e kaluara. • Forcimin e kapaciteteve të stafit në përdorimin dhe aplikimin e teknologjive të reja. • Investime në makineri dhe pajisje për ofrimin e shërbimeve më kualitative. • Mungesa e Oficinës për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinerisë.

MUNDËSITË


- Regjistrimin e konsumatorëve të rinj (amvisëri, biznese dhe institucionë).
- Rritjen e inkasimit dhe krijimin e raporteve me konsumatorë, biznese dhe Institucionë.
- Rritjen e mundësive për investime të reja kapitale dhe pajisjeve të nevojshme.
- Procesin e riciklimit dhe ndërtimin e vijave ricikluese për ndarje sipas standardeve evropiane ne mënyrë që të mbyllët qarkorja ekonomike.
- Fillimi i projektit të riciklimit dhe kompostimit të mbeturinave.
- Digitalizimi i shërbimeve të Ndërmarrjes.
- Projekt për ndërtimin e Qendrës së Transferit.

RREZIQET


- Mungesa e fondeve për investime kapitale
- Amortizimi i makinerive, kosto e madhe në riparimin e tyre,
- Inflacioni dhe kriza ekonomike financiare, çrrregullimi i tregjeve botërore, të cilat kanë ndikim negative ne zhvillimin e kompanisë.

Harta e Komunës së Deçanit e ndarë në 5 zona për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave

NDĒMARRJA PUBLIKE LOKALE
HIGJIENA
Deçan - Republika e Kosovës



3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E N.P.L "HIGJIENA" SH.A.



Ndërmarrja Publike Lokale "Higjiena" Sh.A. udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Zyrtarët e Lartë: Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar, Sekretari dhe Auditori i Brendshëm.

Stafi Menaxhues i Kompanisë përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv i mbështetur nga ekipi i tij i menaxhimit, gjegjësisht nga Menaxherët e Sektorëve.

4. SEKTORI I OPERATIVËS

Sektori i Operativës gjatë vitit 2024, do të maksimizojë përpjekjet për ofrimin e shërbimeve sa me kualitative në grumbullim të mbeturinave për të gjithë qytetarët e komunës së Deçanit. Për të arritur objektivat e përcaktuara, ky sektor duhet të optimalizojë shpenzimet e operimit dhe të personelit duke monitoruar punët në teren, përcjelljen e vazhdueshme të punëtorëve fizik dhe zbatimin me përpikmëri të kontratave për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave gjelbëruese sipas marrëveshjes me Kuvendin Komunal. Këto mund të arrihen përmes:

- Përmirësimi dhe funksionimi të shërbimit nga grumbullimi i mbeturinave përmes modernizimit të pajisjeve dhe mekanizmit teknikë, (kamionët e rinj, auto-fshesa, makineri moderne të riciklimit, kontejner të rinj 120L, 240L, 1.1m³ etj).
- Inicimin e debatit nëpërmes Komisionit Komunal të Aksionerëve, (KKA), Bordit të Drejtorëve (BD), Stafit Menaxhues, Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për Lokacionin e Ri të Qendrës së Transferit, me qëllim të minimalizimit të shpenzimeve për bartjen e mbeturinave, pasi jemi të detyruar që mbeturinat ti bartim në deponinë në Cverrkë.
- Përcaktimin e indikatorëve në lidhje me performancën e personelit operativ dhe atij menaxhues të paracaktuar.
- Aplikimin e masave stimuluese për personelin i cili ka një performancë të mirë dhe aplikimin e masave ndëshkuese përmes komisionit disiplinorë për punëtorët të cilët bëjnë shkeljen e detyrave të punës.

4.1 Pajisjet / Makineritë

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Kamion special-debllokues kanalizimi	1
2	Kamion me kran	1
3	Kamion Volvo 15.00 (FL 220)	1
4	Kamion MAN TG26-360	1
5	Kamion Mercedes Benz 26-28	1
6	Kamion Volvo 24rd	1
7	Kamion MAN 26 343 M-KO	1
8	Kamion Scania	1
9	Kamion Mercedes Benz 26-33	1
10	Eskavator	1
11	Kamion MAN 26-343 M-KO	1
12	Traktor me rimorkio	1
13	Kamion IVECO	1
14	Kamion IVECO	1
15	Pick Up Peugeot	1
16	Kamionetë Ford	1
17	Gjeneratorë	1
18	Veturë Polo 248 208	1
19	Veturë Polo 028 540	1
20	Klima TIP 12 BTU	2
21	Klima Tip BTU	1
22	Kontejner 1.1 metal	11

M.M

23	Ulëse metali me dru	65
24	Kontejner 120L plastic	228
25	Bucher City CET 2020	1

5. SEKTORI FINANCIAR

Sektori Financiar në N.P.L "Higjiena" Sh.A, menaxhon dhe kontrollon të gjitha funksionet financiare dhe të shitjeve në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuara të kontabilitetit në vend. Sektori Financiar organizimin dhe menaxhimin e punëve e kryen përmes Sektorit të Kontabilitetit ku përfshihen bankat dhe arka, kontabiliteti dhe depot, pastaj menaxhimi i aseteve, analiza financiare, buxheti dhe planifikimi financiar.

Objektiv kryesor dhe primar i Sektorit Financiar është menaxhimi i mirë i burimeve financiare, ku me menaxhimin dhe planifikimin e saktë të shpenzimeve operative të Kompanisë të krijon mundësinë e rritjes së fitimit operativ.

Sektori financiar vazhdimisht përgatitë raporte mujore financiare ku treguesit kryesor si arkëtimi, faturimi në euro dhe shpenzimet operative, krahasohen me biznes planin e aprovuar. Punë tjera të sektorit financiar janë përpilimi i raporteve mujore, tre mujore, vjetore, kontroll në zyrën e kontabilitetit financiar dhe kontrollimet e dokumenteve për barazime gjatë regjistrimit, si dhe kontroll e vazhdueshme e arkës.

Sektori Financiar bënë kontrollin e regjistimeve të transaksioneve për regjistrimin e tyre sipas standardeve të kontabilitetit dhe ligjeve financiare në fuqi, kujdeset që me përpikmëri të zbatohen ligjet financiare në përputhje me Administratën Tatimore të Kosovës.

Librat e tatimeve do të mbahen me një përkushtim të madh ashtu që Kompania do ti koordinoj punët me autoritetin tatimor që në të ardhmen gjatë kontolleve të mos kemi obligime tatime shtesë apo gjoba.

5.1 Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Më poshtë kemi paraqitur në formë tabelare planifikimin financiar për vitin 2024, përkatësisht prej datës 1 Janar 2024 deri më 31 Dhjetor 2024:

Planifikimi Financiar: 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024			
NR.	PERSHKRIMI	Të Hyrat:	Shpenzimet:
1.	Të hyrat nga amvisëria	€ 427,440.00	
2.	Të hyrat nga amvisëria (jorezident)	€ 64,176.00	
3.	Të hyrat nga bizneset	€ 93,912.00	
4.	Të hyrat nga kontrata "Në Shtëpi"	€ 266,520.00	
5.	Të hyrat nga kontrata e Objekteve Publike	€ 85,772.40	
6.	Të hyrat nga kontrata Palestra Sportive	€ 144,388.00	
1.	Të ardhurat personale		€ 450,000.00
2.	Shpenzimet e derivateve		€ 153,000.00
3.	Shpenzimet e servisimit të automjeteve		€ 43,832.00
4.	Furnizim me pjesë hidraulike		€ 12,500.00
5.	Shpenzimet e autogomave		€ 39,600.00
6.	Shpenzimet e veglave të punës		€ 36,000.00

7.	Shpenzimet e deponisë	€ 54,000.00
8.	Shpenzimet e materialit për zyre	€ 36,000.00
9.	Furnizim me inventar për zyre	€ 8,000.00
10.	Shpenzimet e amortizimit	€ 25,000.00
11.	Furnizim me pajisje të IT	€ 3,500.00
12.	Furnizim me automjet (veturë)	€ 6,415.00
13.	Furnizim me kamion	€ 20,000.00
14.	Mirëmbajtje e varrezave	€ 69,666.00
15.	Furnizim me autofshisë elektrike	€ 8,250.00
16.	Furnizim me stoli për fundvit	€ 3,333.00
17.	Furnizim me kapak të betonit	€ 1,400.00
18.	Furnizim me kapak të metalit	€ 1,800.00
19.	Furnizim me kapak të ujërave atmosferike	€ 975.00
20.	Furnizim me pemë decorative	€ 6,110.00
21.	Sistemi i monitorimit të GPS	€ 1,800.00
22.	Mirëmbajtje e serverit të kompanisë	€ 6,000.00
23.	Ndërtimi i Qendrës së Transferit	€ 12,450.00
24.	Angazhimi i Eskavatorit (orë)	€ 6,415.00
25.	Ndërtimi i pikave grumbulluese	€ 2,000.00

Mr. M.

26.	Punimi i rrathëve të shtyllave për flamuj		€ 1,220.00
27.	Furnizim me material higjenik		€ 7,450.00
28.	Furnizim me kontejnerë reciklues		€ 3,340.00
29.	Furnizim me uniforma pune		€ 3,500.00
30.	Furnizim dhe montimi i kubëzave të betonit		€ 1,680.00
31.	Konkurs projektimi për objektet përcjellëse të N.P.L "Higjena" Sh.A		€ 2,090.00
32.	Auditimi i pasqyrave financiare		€ 2,000.00
33.	Furnizimi me kamion Kiper 1.5 ton		€ 15,000.00
34.	Sigurimi dhe kontrolla teknike e automjeteve		€ 10,000.00
35.	Vendosja e sistemit të alarmit dhe kamerave të sigurisë		€ 3,600.00
36.	Shtypja e faturave		€ 5,200.00
37.	Konsulent individual për shërbime te veçanta (Kontabilist i Çertifikuar)		€ 500.00
38.	Konsulent individual për shërbime te veçanta (Ekspert i IT)		€ 650.00
39.	Furnizimi dhe montimi i rrrethojave të deponisë ilegale		€ 3,000.00

M. H. r

Gjithsej:	1,082,208.00 €	1,067,276.00 €
Fitimi i planifikuar:		14,932.00 €

6. SEKTORI PËR INKASIM/FATURIM DHE MARRËDHËNIE ME Klientë

Konsumatorët e amvisërive ndahan në dy kategori, në ato që e pranojnë shërbimin derë më derë dhe ata që shërbimi iu ofrohet me kontejnerë kolektivë. Bizneset ndahan në biznese të vogla dhe të mesme, si dhe bizneset e mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Bizneset e vogla dhe të mesme një pjesë e tyre shërbehet derë më derë dhe pjesa tjetër është e pajisur me kontejnerë 120 l apo 240 l, kurse bizneset e mëdha janë të pajisura kryesisht me kontejner $1.1m^3$. Intervali kohor i mbledhjes së mbeturinave është zakonisht nga ora 07:30 - 15:30. Duke pasur parasysh që kompania ka shtrirë shërbimin në 100% të territorit të komunës së Deçanit, në kuadër të planifikimit për vitin 2024, N.P.L "Higjiena" Sh.A., objektivin do ta ketë tek regjistrimi i konsumatorëve të rinj sipas Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ligjt për Mbeturina, në të gjitha zonat ku ofron shërbim, konsumatorë këta të cilët deri më tanë nuk kanë qenë pjesë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, për shkak që kanë kundërshtuar regjistrimin. Gjatë vitit 2024, Sektori për Inkasim/Faturim dhe Marrëdhënie me Konsumatorë do të vazhdojë me përgatitjen e faturave për konsumatorët e Amvisërisë, Biznesit të Vogël, Biznesit të Madh dhe Institucioneve dhe shpërndarjen e tyre nëpërmes inkasantëve dhe personelit të angazhuar në Kompani.

Pagesat e faturave realizohen në sportelet e N.P.L "Higjiena" Sh.A., duke filluar nga ora 08:00-16:00 (e Hënë - e Premte), po ashtu mund të realizohen përmes inkasantëve të Kompanisë.

Njëkohësisht pagesat e detyrimeve konsumatorët mund t'i kryejnë edhe përmes xhilologarive bankare.

Sipas të dhënave të fundit të dates 31.10.2023, klientët e N.P.L "Higjiena" Sh.A përfshijnë:

Kategoria	Numri i klientëve
Rezident	5200 klientë
Jorezident	2674 klientë
Biznese	539 klientë
Totali	8413 klientë

6.1 Zgjerimet në zonat rurale

Qëllimi i N.P.L “Higjiena” Sh.A., është plotësimi i shërbimit dhe regjistrimit të konsumatorëve në zonat rurale dhe urbane të Komunës së Deçanit, pengimin e hedhjes se mbeturinave rrëth fshatrave dhe lumenjve, pengimin e krijimit të deponive të egra, pengimin e mëtutjeshëm të ndotjes së sipërfaqes së tokës, e cila rrezikon shëndetin e banorëve të këtyre fshatrave të komunës sonë. Komuniteti i zonave rurale i Komunës sonë çdo ditë që nga pas lufta përballet me këtë problem dhe zgjidhjet që kanë bërë për largimin e mbeturinave kanë qenë jo të mira (hedhja e mbeturinave në lumenj ka bërë që niveli i ndotjes së lumenjve të jetë i lartë, hapja e gropave dhe futja e mbeturinave në toke, ka bërë që të lirohen gazra helmues – është bërë ndotja e ajrit dhe njëkohësisht edhe e tokës gjë që ndikon në prodhime bujqësore të dëmshme për jetën e njeriut). Pra qëllimi është të kemi ambient të pastër, ekologjik dhe shëndet të mirë të banorëve të komunitetit.

6.2 Çmimorja e tarifave të konsumatorëve

Në tabelën e mëposhtme, kemi paraqitur çmimoren duke i kategorizuar klientët e N.P.L “Higjiena” Sh.A.:

Kategoritë	Tarifa (mujore)
Amvisëri	6.85 €
Amvisëri jo resident	2.00 €
Bizneset (të vogla, të mesme)	14.52 € (mesatare)
Bizneset (të mëdha)	Të veçanta (me zbrasje)

7. SEKTORI ADMINISTRATIV JURIDIK

Sektori Administrativ Juridik bën menaxhimin e shërbimeve në fushën e administritimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të Drejtoreve, mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarit si dhe Komisionit të Auditimit, bënë azhurnimin e ueb-faqes së kompanisë, punëve administrative dhe juridike në përfaqësimin e kompanisë në të gjitha gjykatat në kontestet e natyrave të ndryshme, mban Politikat e Mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe Mbrojtjes dhe Sigurimit të objekteve, si dhe kryen edhe shërbime tjera përmes Njësisë së kryerjes së shërbimeve Ligjore.

Sektori Administrativ përmes Njësive në kuadër të këtij Sektori në vazhdimësi do të kushtojë rëndësi dhe vëmendje politikave të reja të miratuara nga Bordi i Drejtoreve si dhe me kohë dotë aplikojë dispozitat ligjore të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ligjit të Punës, akteve nënligjore të nxjerra nga Qeveria e Kosovës si dhe Rregulloreve të hartuara nga Kompania komfor ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi në Kosovë.

7.1 Njësia e Burimeve Njerëzore

Njësia e Burimeve Njerëzore do të fokusohet në stabilizim dhe modernizim të sistemit (të punonjësit, procesit dhe organizimit) duke ndërtuar së pari infrastrukturën dhe duke identifikuar nevojat e fuqisë punëtore për trajnim dhe zhvillim të mëtejshëm.

Karakteristikat e Njësisë së BNJ janë plotësimi i nevojave të Burimeve Njerëzore duke u mbështetur në Strategjinë e Ndërmarrjes dhe Plan Biznesit të saj, përkrahja e politikave dhe praktikave të punësimit, adaptimit dhe integrimit të burimeve njerëzore duke zbatuar politikat e zhvillimit të tyre si dhe krijimi i hapësirave dhe mundësive të punëtorëve në mënyrë të vazhdueshme në rekrutimin dhe përzgjedhjen e njerëzve me cilësi të lartë; në një fuqi punëtore të kualifikuar dhe e trajnuar si duhet; vazhdimësi e rekrutimit të stafit të ri profesional në

kuadër të të gjitha Sektorëve të Ndërmarrjes në përputhshmëri ligjore dhe efikasitet në politikat e brendshme.

7.2 Njësia Ligjore

Do të angazhohet në hartimin e Rregulloreve të brendshme të Kompanisë dhe interpretimi i të njëjtave; Harmonizimi rregulloreve te brendshme me Ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.; Ofrimi i këshillave juridike për stafin e Kompanisë; Mbështetje ligjore për projekte; Menaxhim të lëndëve gjyqësore te autoritetet gjyqësore dhe përmbaruesit privat; Implementim i procedurave gjyqësore bazuar në planifikimin e ngritjes së padive për borxhet ndaj konsumatorëve nga Sektori Financiar; Hartimi i vendimeve, akteve për politikat e brendshme të kompanisë; Ofrimin e sqarimeve juridike për çështje të caktuara që janë kërkuar sipas nevojës së Kompanisë; Përfaqësimi i Kompanisë tek autoritete të ndryshme institucionale sipas autorizimeve nga Udhëheqësi i Sektorit Administrativ ose Kryeshefi Ekzekutiv. Varësisht nga planifikimi që do ta bëjë Sektori i Shitjes për inkasimin e borxheve përmes Përmbaruesve Privat, kjo Njësi bënë përcjelljen e lëndëve përmes Propozimit për Ekzekutim tek Përmbaruesit Privat, këtë do ta realizojë me kohë dhe ne mënyre plotësisht profesionale.

7.3 Njësia e Arkivit

Kërkесat e punëtorëve planifikohet të kryhen shpejt dhe në mënyrë efikase. Aktivitetet e nevojshme nga marrëdhënia e punës të kryhen në përputhje me kërkесat e stafit të kompanisë dhe dispozitave të aplikueshme ligjore. Planifikohet të kryhet arkivimi dhe sistematizimi i dokumenteve të kompanisë me një numër te konsiderueshëm te dokumenteve në kuadër të zyrës së Arkives. Arkivimi i dokumenteve do të bëhet në formë fizike dhe elektronike dhe do të jetë i gatshëm dhe i qasshëm kurdo që kërkohet ndonjë dokument për nevojat e Kompanisë.

7.4 Njësia për Sigurinë e Objekteve dhe Mbrojtja e Punëtorëve

Në kuadër të Sektorit Administrativ në Njësinë e Mbrojtjes në Punë të punëtorëve dhe Sigurimi i Objekteve, që rregullojnë çështjet në fushën e mbrojtjes në punë, mbrojtjes nga zjarri, kontroll i vazhdueshmen i objekteve të ndërtesës, servisimi i aparatave kundër zjarrit të Objekteve; Furnizimi i punëtorëve me rrobat e punës komfor Planifikimit për Rroba të Punës, dhe mjetet e nevojshme për mjetet e mbrojtëse.

7.5 Mbrojtja në punë e punëtorëve

Siguria dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Furnizimin me mjetet adekuate për punë, furnizimi me uniforma të përshtatshme për punë dhe sigurimi i masave mbrojtëse në vendin e punës.

8. SEKTORI I PROKURIMIT

8.1 Planifikimi i Planit të Prokurimit

Për një planifikim të mirë të prokurimit, Zyrtarit të Prokurimit i nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me sektorin e financave dhe sektorët tjera të Ndërmarrjes. Zyrtari i prokurimit në bashkëpunim me Zyrtarin Kryesor Financiar dhe Menaxherët e Sektorëve që bëjnë kërkuesit (përdoruesit), kanë

diskutuar kërkesat e tyre për prokurim dhe disponueshmërin e buxhetit për vitin e ardhshëm, dhe është vendosë se cilët artikuj të përfshihen në planifikimin paraprak dhe final të prokurimit.

Më poshtë është bërë përshkrimi përbledhës i kontratave të planifikuara për vitin fiskal 2024:

Nr.	Furnizime	Kohëzgjatja e Kontratës	Vlera e parashikuar
1	Furnizim me pajisje te IT-se	12 muaj	4,500.00 €
2	Furnizim me invertar për zyret e N.P.L "Higjiena" Sh.A.	12 muaj	8,000.00 €
3	Furnizim me pjesë hidraulike (pompa, komanda, reduktor dhe gypa)	24 muaj	25,000.00 €
4	Furnizim me automjete për N.P.L "Higjiena" Sh.A	12 muaj	25,000.00 €
5	Furnizim me autofshisë të përdorur për Njësinë e Operativës	12 muaj	9,000.00 €
6	Furnizim me stoli për festat e fundvitit	30 ditë	16,000.00 €
7	Furnizim me kapak të pusetave	36 muaj	12,525.00 €
8	Furnizim me lule dhe pemë dekorative	36 muaj	20,000.00 €
9	Furnizimi dhe montimi i shtyllave për vendosjen e flamujve	12 muaj	4,000.00 €
10	Furnizim me material higienik	36 muaj	30,000.00 €
11	Furnizim me kontejnere per ndarjen dhe reciklimin e mbeturinave	24 muaj	10,000.00 €
12	Furnizim me uniforma dhe mjete pune	36 muaj	20,000.00 €
13	Furnizim me Kamion kiper 1.5 ton - I përdorur	12 muaj	15,000.00 €
14	Shtypja e faturave	12 muaj	500.00 €
15	Pako dhurata për Vitin e Ri	30 ditë	1,500.00 €
16	Furnizim me aparate digitale per numerimin e parave	12 muaj	990.00 €
Total			202,015.00 €

Nr.	Shërbime	Kohëzgjatja e Kontratës	Vlera e parashikuar
1	Servisimi i automjeteve të N.P.L.HIGJIENA SH.A.	36 muaj	125,000.00 €
2	Mirëmbajtja e varrezave publike në Komunën e Deçanit	36 muaj	228,000.00 €
3	Sistemi për monitorim dhe menaxhim të automjeteve përmes GPS	12 muaj	6,000.00 €
4	Mirëmbajtja e Serverit brenda Kompanisë	36 muaj	18,000.00 €
5	Konkurs projektimi për objektet përcjellëse të N.P.L.HIGJIENA Sh.A	30 dite	5,000.00 €


6	Auditimi i paqyrave financiare	36 muaj	6,000.00 €
7	Vendosja e sistemit te alarmit dhe monitorimi i kamerave te sigurise	12 muaj	3,600.00 €
8	Sigurimi dhe kontrolla teknike e automjeteve	12 muaj	14,000.00 €
9	Konsulent individual per sherbime te vecanta-Kontabilist i certifikuar	12 muaj	500.00 €
10	Konsulent individual per sherbime te vecanta - Ekspert i IT-se	12 muaj	1,200.00 €
11	Shërbime të marketingut	12 muaj	900,00 €
	Total		408,200.00 €

Nr.	Punë	Kohëzgjatja e Kontratës	Vlera e parashikuar
1	Ndërtimi i Qendrës së Transferit	24 muaj	50,000.00 €
2	Ndërtimi i pikave grumbulluese për mbeturina	36 muaj	12,000.00 €
3	Montimi dhe Mirëmbajtja e kubezave te betonit ne ambientet publike	12 muaj	6,750.00 €
4	Furnizimi dhe montimi i rrethojave ne deponi ilegale ne territorin e Komunes se Deçanit	30 dite	3,000.00 €
	Total		71,750.00 €

M.U.

9. PLANI I MARKETINGUT

Një plan i qartë marketingu, është baza kryesore që ky plan biznesi të arrijë objektivat e tij. Për Ndërmarrjen Publike Lokale "Higjiena" Sh.A., është me rëndësi jetike që të arrijë kënaqësinë e klientëve të saj, përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe në kohë. Për të analizuar kënaqësinë, mendimet, sugjerimet, ankesat e të ngjashme, të klientëve ne planifikojmë që të realizojmë anketa që të kemi një pasqyrë sa më reale të pozicionit të Kompanisë në sytë e klientëve të saj. N.P.L "Higjiena" Sh.A, shfrytëzon kanalet e saj më të frekuentuara për të arritur një marketing i cili ndihmon në rritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të Kompanisë.



Ueb faqja-është kanali i cili ndikon më së-shumti në identitetin e Kompanisë. Si çdo ueb faqe e suksesshme, edhe kjo duhet të jetë e lehtë për tu naviguar si dhe të ketë një pamje dhe dizajn tërheqës. Strukturimi dhe menaxhimi i mirë i ueb faqes flet shumë për kompaninë, prandaj në të duhet të përfshihen të gjitha informatat për kompaninë dhe veprimtarinë e saj qysh nga themelimi e deri më sot, si dhe të bëhet rifreskimi i rregullt i saj. Ueb faqja e N.P.L "Higjiena" Sh.A është www.higjiena.com, e cila është lehtë e qasshme për konsumatorët dhe publikun.

Facebook-është një platformë komunikimi e rëndësishme për kompaninë, prandaj prania aktive në Facebook është thelbësore për të qëndruar në kontakt me mbështetësit, për të ndërtuar një bazë të njerëzve të angazhuar në misionin e kompanisë dhe për të përcjellë mesazhe të fuqishme me fotografi të ndryshme dhe me tekst të cilat njëherit promovojnë punën nga tereni, me moton “Për një qytet të pastër”. Duke pasur parasysh se shumica e njerëzve me qasje në internet kanë profilin e tyre në Facebook, kompania duhet t'i jap rëndësi kyçë këtij kanali komunikimi. Një strategji e Facebook-ut është pjesë e pandashme e përpjekjeve të një kompanie për promovim cilësor, dhe është e nevojshme për të plotësuar mjete të tjera të komunikimit. Për të rritur numrin e ndjekësve të faqes dhe numrin e pëlqimeve, është i nevojshëm përditësimi aktiv i faqes. Facebook-u është një rrjet social mjaft i lehtë për t'u përdorur dhe goxha i popullarizuar sim jet komunikimi.

10. PROJEKTET, SFIDAT DHE REZULTATET E PRITSHME

Për vitin 2024, Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” Sh.A, ka identifikuar disa projekte me rëndësi të veçantë për implementimin e tyre.

Me rëndësi shumë të madhe është vlerësuar fillimi i Ndërtimit të Qendrës së Transferit, në Komunën e Deçanit, duke marrë parasysh që aktualisht Kompania është e detyruar që mbeturinat ti bartë ne deponinë në Cverrkë, e cila administrohet nga KRM “Ambienti” Sh.A, e cila është kosto shtesë si në amortizimin e makinerive, po ashtu në shpenzimet e karburantit dhe shpenzimet e deponisë. Kompania synon që në vitin 2024, të fillojë Ndërtimin e Qendrës së Transferit, e cila do i ndihmonte shumë Kompanisë dhe do t'i sillte shumë avantazhe në jetëgjatësinë e makinerive dhe uljen e shpenzimeve të lartcekura.

Një projekt tjetër me rëndësi që planifikohet për vitin që po hymë është planifikimi i një konkursi projektimi për objektet përcjellëse të N.P.L “Higjiena” Sh.A, objektin administrativ si dhe gendrën e ndarjes së mbeturinave (letër, plastikë, kanaqe, qelq, etj), duke përfshirë këtu edhe

furnizimin me kontejnerë për ndarjen e mbeturinave, që do të ndihmonte të implementojmë procesin e riciklimit të mbeturinave.

Rritja e inkasimit e borgjeve të akumuluara si dhe rritja e eficiencës në inkasim vazhdon të jetë ndër qëllimet kryesore të Kompanisë, në mënyrë që të fitohet stabilitet financiar dhe operim cilësor i shërbimeve.

Gjatë vitit 2024, Kompania synon që përmes këtij Plan Biznesi, të përmirësojë veten e saj në çdo aspekt dhe të ngrisë nivelet e saj në çdo formë.

Aprovuar nga:

MILAZIM MUSHKOLAJ



31. 10. 2023

Kryesues i Bordit të Drejtoreve
N.P.L "Higjiena" Sh.A. Deçan